

RAPORT VJETOR I PUNËS SË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM TË KOMUNËS SË DRENASIT SI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE PËR VITIN 2023

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT.

Instituti i Auditorëve të Brendshëm (IAB) , standardet e të cilit janë bazë e Standardeve të Auditimit të Brendshëm në Republikën e Kosovës, e përshkruan Auditimin e Brendshëm si:

Auditimi i brendshëm është aktivitet i pavarur , aktivitet me siguri të arsyeshme, objektive , dhe konsultativ, i përcaktuar që të shtoj vlerat dhe të përmirësoj funksionet e organizatës. Ky aktivitet ndihmon menaxhmentin në rritjen e vlerës dhe në vendimmarrje.

Ai ndihmon organizatën që të përmbushë objektivat e saja duke paraqitur një qasje sistematike, profesionale dhe të diciplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proqesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe vendimmarrjes.

Auditimi i brendshëm është një funksion vlerësues i pavarur i cili mbledh, klasifikon, vlerëson dhe raporton të dhënat duke i ofruar menaxhmentit një siguri të arsyeshme dhe të besueshme se në çfarë mase janë duke u përmbushur objektivat e sistemit dhe në çfarë shkalle të rrezikut gjendet ai sistem nga keqinterpretimet, keqmenaxhimet, keqdeklarimet, shpërdorimet, mashtrimet , humbjet etj.

Me aprovimin e Ligjit nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike është përcaktuar koha e hartimit dhe dorëzimit të Planit Strategjik dhe Planit vjetor të angazhimeve të kapaciteteve audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës. Kështu, gjatë muajit Dhjetor të vitit 2022 është hartuar Plan Strategjik i Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit për periudhën 2023-2025 me dt. 27.12.2022, me nr. protokoli 01/030 – 65935 ku janë paraparë Objektivat kryesore për një cikël trevjeçar të auditimeve, si dhe Plan vjetor i angazhimit të kapaciteteve audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 me dt. 27.12.2022 me nr. protokoli 01/030-65948.

Ky Plan Strategjik dhe Plan Vjetor janë aprovuar paraprakisht nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit sipas kërkesave të Ligjit nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Këto Plane janë hartuar duke u bazuar në vlerësimin e rregullt vjetor të rrezikut për të gjitha fushat që përbëjnë universin e auditimit në Komunën tonë. Pas vlerësimit të shkallës së rrezikut për secilen fushë të identifikuar, është bërë rangimi i detyrave të punës audituese duke u bazuar në kapacitetet audituese ekzistuese në komunën tonë. Këto Plane Strategjike dhe Vjetore pasi që janë aprovuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, janë dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm .

Pas aprovimit të këtyre dy planeve, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka filluar me auditimet e parapara për vitin 2023 sipas orarit të paraqitur në Planin Vjetor.

Sipas rregullatave ligjore, Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregullores për themelimin dhe funksionimin e Komiteteve të Auditimit të Brendshëm, është kompetencë e Komitetit të Auditimit të Brendshëm që të bëjë aprovimin e Planeve Strategjike dhe Vjetore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe të shërbejë si ndërmjetësues në mes të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe ZKA-së me qëllim të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Llojet e auditimeve që janë kryer gjatë vitit 2023 kanë paraqitur tri tipet e auditimit si: auditimet preventive (parandaluese), auditimet detektive (zbuluese), dhe auditimet direktive (nxitëse).

Auditimet dhe rekomandimet preventive kanë pasur për qëllim parandalimin e ngjarjeve të padëshirueshme dhe kanë të bëjnë me këshillimet e menaxhmentit gjatë vendimmarrjes. Në këtë grup hynë edhe shërbimet këshilldhënëse dhe të konsulencës që stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm i ka ofruar gjatë periudhës që mbulohet nga ky raport i punës.

Auditimet detektive ishin auditime zbuluese (ex- post) dhe zakonisht kanë përfunduar me një numër të caktuar të rekomandimeve për vëmendje për menaxhmentin.

Auditimet dhe rekomandimet direktive kishin për qëllim për të shkaktuar dhe inkurajuar ndodhjen e ngjarjeve të dëshirueshme.

Angazhimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2023 ka pasur për qëllim realizimin e auditimeve të planifikuara sipas Planit të punës për këtë vit, si dhe kryerjen e rishiqimeve për auditimet e kryera sipas Planit të veprimit të pranuar nga menaxherët e drejtorateve ku ishte kryer auditimi. Në lidhje me këtë, dy here brenda vitit është hartuar Raport sipas kërkesave të formularit standard 4001 në lidhje me progresin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Këto Raporte janë diskutuar së bashku me Kryetarin në mbledhjet e rregullta të Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Puna që është kryer gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 i referohet pikërisht përmbushjes së objektivave të parapara me Planin Strategjik dhe Planin vjetor.

Sipas Planit vjetor të angazhimit të kapaciteteve audituese për vitin 2023 ishin paraparë të kryheshin gjithësej 7 (shtatë) auditime për dhënje të sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore - Komunën e Drenasit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka raportuar pas çdo auditimi të kryer me Raport të Auditimit dhe poashtu ka raportuar edhe në baza gjashtë mujore siq parashifet edhe me Ligjin nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, përmes formave standarde të raportimit në Komitetin e Auditimit dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transvereve. Njëherit këto organe janë njoftuar edhe me shkallën e adresimit të rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve paraprake.

Gjatë vitit 2023, stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka bashkëpunuar ngushtë edhe me auditorët e Zyres Kombëtare të Auditimit gjatë kryerjes së auditimit të rregullt vjetor të pasqyrave financiare, si dhe është angazhuar edhe në adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e tyre.

Një vëmendje e caktuar i është kushtuar edhe vlerësimit vjetor të shkallës së rrezikut me të cilin afaron komuna si dhe në përgaditjen e Listes së rreziqeve komunale për vitin 2024.

Poashtu gjatë vitit 2023 stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka ndjekur edhe trajnimet e ofruara nga ana e Njesisë Qendrore Harmonizuese, USAID, DEMOS, etj për të realizuar Avancimin e Vazhdueshëm Profesional.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË VITIT 2023.

Sipas Planit vjetor të angazhimit të kapaciteteve audituese për vitin 2023 ishin paraparë të kryheshin 7 (shtatë) auditime të cilat janë kryer në tërësi dhe janë raportuar me raport me shkrim para Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Gjatë vitit 2023 janë kryer këto auditimet në këto entitete:

1. Auditimi i proqesit të menaxhimit me pasuritë jofinanciare të Komunes . Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2022 – 31.12.2022.
2. Auditimi i proqeseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga dhënja e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2021 – 31.12.2022.
3. Auditimi i menaxhimit me resurset humane në sektorin e Arsimit. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2022 – 31.03.2022
4. Auditimi i proqeseve të inkasimit të të hyrave vetanake në Drejtoratin e Administratës së Përgjithshme, Drejtoratin e Arsimit dhe Drejtoratin e Shëndetësisë. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2023 – 30.04.2023.
5. Auditimi i proqeseve të shpërndarjes së subvencioneve gjatë vitit 2023. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2023 – 30.06.2023.
6. Auditimi i proqeseve të prokurimit gjatë vitit 2023. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2023 – 31.07.2023.
7. Auditimi i proqesit të pagesave/shpenzimeve gjatë vitit 2023. Fushëveprimi i auditimit: 01.01.2023 – 24.10.2023

TË DHËNAT STATISTIKORE

Secili nga auditimet e kryera ka përfunduar me një Raport të shkruar i cili raport ju është dorëzuar : entitetit të audituar, Kryetarit të Komunës , si dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Në këto shtatë auditime të kryera gjatë vitit 2023 janë dhënë gjithësej 50 rekomandime për përmirësimin e kontrollave të brendshme të vendosur nga menaxhmenti dhe për funksionalizimin e tyre. Sipas vlerësimit vjetor të implementimit të rekomandimeve është konstatuar se nga këto rekomandime të dhëna, 25 prej tyre janë implementuar, 17 janë në proqes të implementimit, ndërsa 8 janë të adresuara mirëpo ka pasur një kohë shumë të shkurtër nga momenti kur këto janë dhënë deri te momenti kur kemi raportuar, andaj nuk kanë mundur të implementohen në këtë fazë.

Gjatë vitit 2023, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka monitoruar edhe shkallen e implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë kryerjes së auditimeve.

Rekomandimet e pa implementuara deri në periudhën gjashtëmujore, në të dhënat audituese do të evidentohen si detyra për gjashtëmujorin e ardhshëm, ndërsa ato të pa implementuara deri në fund të vitit kalendarik, do të mbesin në databazen e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për përkujdesje të vazhdueshme për implementimin e tyre në vitin në vazhdim.

Për të siguruar avancimin e vazhdueshëm profesional, auditorët e Njësisë së Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2023 kanë pasur edhe trajnime, seminare dhe tryeza pune të organizuara nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, USAID dhe DEMOS.

Gjatë kësaj periudhe, me institucionet e përmendura janë mbajtur dhjete takime pune, tryeza dhe punëtori ku janë diskutuar tema nga sfidat e përgjithshme për avancimin e proqesit të auditimit, vlerësimin e rreziqeve, hartimin e Planeve të auditimit, rritjen e shkallës së implementimit të

rekomandimeve, auditimet e përformancës, si dhe prezantimin e përmbushjes së kriterëve të përformancës.

TAKIMET E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.

Komuna e Drenasit ka të formuar Komitetin e Auditimit të Brendshëm që nga viti 2009 e këtej. Në vazhdimësi ky Komitet ka qenë aktiv dhe gjatë të gjitha viteve ka mbajtur takimet e rregullta të parapara me ligj.

Komiteti i Auditimit ka të hartuar edhe Statutin e vet dhe në këtë aspekt jemi komunë lidere sa i përket themelimit dhe funksionimit të Komitetit të Auditimit.

Anëtarët e Komitetit i përmbushin të gjitha kriteret ligjore të kërkuara me Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komiteteve të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik.

Gjatë vitit 2023 ky Komitet ka mbajtur katër takime të rregullta të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2019 ku ka diskutuar dhe aprovuar Planet e Njesisë së Auditimit, Raportet e auditimit, Raportimet gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe shkallën e implementimit të rekomandimeve. Këto takime janë mbajtur sipas orarit të përcaktuar me këtë Udhëzim:

Takimi i parë është mbajtur me dt. 05.01.2023 ku janë shqyrtuar dhe aprovuar raporte të auditimit, Raporti i implementimit të rekomandimeve nga viti 2022, Raporti gjashtëmujor dhe vjetor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe Planit Strategjik dhe Planit vjetor i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Takimi i dytë është mbajtur me dt. 18.04.2023 ku janë shqyrtuar dhe aprovuar dy raporte të auditimit për auditimet e kryera nga ana e Njesisë së Auditimit.

Takimi i tretë është mbajtur me dt. 14.07.2023 ku janë shqyrtuar katër raporte të auditimit të kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Takimi i katërt është mbajtur me dt. 13.10.2023 ku janë shqyrtuar dhe aprovuar dy raporte të auditimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

SFIDAT, PROPOZIMET DHE REKOMANDIMET.

- Njoftimi me kohë me ndryshimet legislative dhe aplikimi i tyre brenda afateve sa më të shkurta.
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit e në veqanti në fushat ku ka ndryshime të legjislacionit dhe trajnimet për qasje në sistemin e Free- Balancit.
- Mundësimi i trajnimeve përmes IKAF-it (trajnime me pagesë).
- Zhvillimi i auditimeve të përformances veqanërisht në disa prej fushave.
- Ushtrimi i mbikqyrjes së projekteve në mënyrë të vazhdueshme gjatë realizimit të tyre.
- Përgaditja e stafit alternativ për një numër të madh të funksioneve komunale për ushtrimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të përditshme komunale.
- Angazhimi më i madh në aktivitetet për implementimin e rekomandimeve të Auditorit.
- Përkrahja dhe fuqizimi i mëtutjeshëm i Komitetit të Auditimit;
- Përkrahja e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në proqesin e trajnimit;
- Kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm me gjithësej 3 auditorë.
- Angazhimi i menaxhmentit të lartë për jetësimin e rekomandimeve .
- Realizimi i Planit vjetor të Auditimit për vitin 2024;
- Realizimi i Planit strategjik të auditimit për tri vitet e ardhshme;
- Përmirësimi i kushteve të punës për Auditorë;
- Paisja me teknologji informative dhe aparaturë tjetër për kryerjen e auditimit.

PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE.

Secili nga auditimet e kryera ka përfunduar me një raport të shkruar për menaxhmentin ku janë dhënë edhe rekomandimet tona për adresim të qështjeve në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kontrollave të brendshme tanimë të vendosura nga ana e menaxhmentit.

Gjatë arritjes së konstatimeve tona kemi pasur parasysh që ato të jenë sa më të argumentuara, reprezentative dhe të qëndrueshme.

Në raportet tona kemi dhënë informata të mjaftueshme në lidhje me popullacionin ekzistues, numrin e mostrave të ekzaminuara, gjendjen e konstatuar, ndikimin e mundshëm negativ, si dhe jemi përpjekur që të analizojmë edhe shkaqet. Rekomandimet tona kanë qenë të orjentuara në drejtim të eliminimit të shkaqeve që kanë quar deri te të gjeturat e caktuara. Kujdes i veçantë i është kushtuar formulimit të rekomandimeve në mënyrë që ato të jenë të bazuara në Ligj, lehtë të kuptueshme nga ana e menaxherëve dhe mos të jenë të kushtueshme nga ana financiare.

Pas çdo finalizimi të raportit të auditimit, menaxhmentit i është dërguar edhe Modeli i veprimit për adresimin e rekomandimeve ku në një afat prej 15 ditëve menaxherët kanë plotësuar këtë formularë duke shënuar në kolonat përkatëse të formularit aktivitetet që do të ndërmarrin për adresimin e rekomandimeve, personat përgjegjës për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe afatin në të cilin do të mund të kryheshin këto aktivitete në mënyrë që të bëhet implementimi i rekomandimeve.

Pas plotësimit të këtij formulari nga ana e menaxhmentit të audituar, auditorët kanë përpiluar orarin e verifikimit të zbatimit të këtyre aktiviteteve dhe gjatë gjithë vitit varësisht nga afati i caktuar, është kryer verifikimi i shkallës së adresimit dhe implementimit të rekomandimeve tona.

Në lidhje me këtë, Njësia e Auditimit të Brendshëm dy here brenda vitit ka raportuar mbi gjendjen e rekomandimeve të dhëna duke i klasifikuar ato si: të implementuara, në proqes të implementimit, apo të pa implementuara ende.

Gjatë vitit 2023 nga shtatë raporte të finalizuara janë dhënë gjithësej 50 rekomandime nga ana jonë. Sipas Raportit të verifikimit të implementimit të rekomandimeve të kryer në fund të vitit 2023, ka rezultuar se menaxhmenti ka implementuar plotësisht 25 rekomandime apo 50%, 17 rekomandime apo 34% janë në proqes të implementimit, pra janë implementuar pjesërisht, si dhe 8 prej tyre ishin të pa implementuara.

Rekomandimet e pa implementuara ishin të gjitha të dhëna në Raportin e fundit të auditimit i cili ishte finalizuar me dt. 28.12.2023 dhe se nuk kishte një kohë të mjaftueshme për ndërmarrjen e aktiviteteve për implementimin e tyre me që kishte vetëm dy ditë deri në përfundim të vitit dhe nuk kishte një periudhë krahasuese.

Të gjitha rekomandimet e dhëna gjatë këtij viti ishin të pranueshme nga ana e menaxhmentit dhe për to ishte hartuar edhe Plan i veprimit për jetësimin e tyre.

Gjatë vitit ishin vërejtur edhe rezultatet konkrete nga implementimi i rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të financave publike.

Menaxhmenti ka qenë i përkushtuar gjatë gjithë vitit për implementimin e rekomandimeve tona dhe është vërejtur aktiviteti i shtuar për implementimin e rekomandimeve.

Në të gjitha fushat e rekomanduara janë zhvilluar aktivitetet e parapara për zbatimin e rekomandimeve. Me verifikimin e fundvitit 2023, ne kemi identifikuar 58 aktivitete të menaxhmentit në fushat e audituara.

Në fushën e auditimit të menaxhimit me pasuritë jofinanciare të Komunës, janë dhënë gjashtë rekomandime. Në lidhje me implementimin e këtyre rekomandimeve, menaxhmenti ka ndërmarrur 12

aktivitete dhe ka arritur që të implementoj plotësisht katër rekomandime dhe pjesërisht dy rekomandime.

Në fushën e auditimit të proqeseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga dhënja e tokës komunale në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, janë dhënë 5 rekomandime. Menaxhmenti ka ndërmarrur 7 aktivitete dhe ka arritur që të implementoj plotësisht 2 dhe pjesërisht 3 rekomandime.

Në fushën e auditimit të menaxhimit me resurset humane në sektorin e arsimit janë dhënë gjithësej 6 rekomandime. Menaxhmenti ka ndërmarrur 10 aktivitete dhe ka arritur që të implementoj plotësisht të gjitha rekomandimet.

Në fushën e auditimit për rishiqimin e proqesit të inkasimit të të hyrave vetanake në Sektorin e Administratës së përgjithshme, Sektorin e Arsimit dhe Sektorin e Shëndetësisë janë dhënë gjithësej 11 rekomandime. Menaxherët kanë ndërmarrur 14 aktivitete dhe kanë arritur që të implementojnë plotësisht 8 rekomandime, dhe pjesërisht 3 rekomandime.

Në fushën e shpenzimit të subvencioneve janë dhënë 6 rekomandime, menaxhmenti ka ndërmarrur 7 aktivitete dhe ka implementuar plotësisht 1 rekomandim dhe pjesërisht 6 rekomandime.

Në fushën e audituar të proqeseve të prokurimit janë dhënë 8 rekomandime. Menaxhmenti ka ndërmarrur 8 aktivitete dhe ka implementuar plotësisht 4 rekomandime, dhe pjesërisht 4 rekomandime.


Për auditimin e shpenzimit të buxhetit komunal gjatë vitit 2023 janë dhënë gjithësej 8 rekomandime por meqë raporti është finalizuar në ditët e fundit të vitit 2023, nuk ka një periudhë krahasuese sa i përket verifikimit të aktiviteteve dhe implementimit të rekomandimeve. Këto rekomandime, si dhe rekomandimet e zbatuara pjesërisht mbeten në databazën e Njesisë së Auditimit për përcjellje gjatë vitit 2024.

Ne dëshirojmë të falenderojmë menaxhmentin për aktivitetet e zhvilluara në funksion të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe gjithashtu inkurajojmë menaxherët që ende nuk kanë arritur përmbushjen e plotë të rekomandimeve tona që të angazhohen edhe më tutje për implementimin e plotë të të gjitha rekomandimeve.

Drenas, 18.01.2024



Njësia e Auditimit të Brendshëm :


Kamer Ramaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr. 030/d-3693 dt. 19.01 2024



Të nderuar anëtarë/e të Kuvendit,

Duke u bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, ku përcaktohet se; Komuna mbikëqyrë realizmin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme sipas planit dinamik realizues, andaj përmes kësaj shkrese përcjellëse, për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa i cili do të mbahet me datën 22.01.2024 si dhe për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës, ju bashkëngjisë Raportin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Realizimit të Kontratave për Dhënien në Shfrytëzim të Pronave të Paluajtshme të Komunës të Dhëna në Shfrytëzim gjatë vitit 2020.

Këtë Raport të Komisionit ju dërgoj për pikë të rendit të ditës për mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit, duke respektuar ligjin e lartcekur dhe për hirë të transparencës e llogaridhënies.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



**Komisioni për Mbikëqyrjen e Realizimit të Kontratave
për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të
Komunës gjatë Vitit 2020**

01 Nr. 052/01-61814 të datë 21.12.2023

Duke u bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci me Nr.protokolli 01-020/04-13832 të datës 20.04.2023 me të cilin vendim është formuar komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës gjatë Vitit 2020, Komisioni në përbërje të plotë pas verifikimit të kontratave dhe gjendjes në terren, paraqet këtë:

R A P O R T

**I KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E REALIZIMIT TË KONTRATAVE PËR
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS TË
DHËNA NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2020**

Në bazë të vendimit të Kryetarit Nr. 01-020/04-13832 të datë 20.03.2023 komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës gjatë Vitit 2020, komisioni sot më datën 20.12.2023 ishim në vend shiqim për bizneset ku Komuna e Drenasit ua jep në shfrytëzim afatgjatë pronat e paluajtshme të Komunës, gjatë vitit 2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Glllogocit (Autoritetit Kontraktues), e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z.Ramiz Lladrovci dhe Operoret Ekonomik.

Në momentin e vizitës në terren të Operatorit Ekonomi IP-KOS SHPK në Glllogoc gjendja është konstatuar se Operatori Ekonomik IP-KOS SHPK me pronar Burim Leci dhe me kontratë të nënshkruara nga kryetari z.Ramiz Lladrovci dhe Burim Leci, Drejtor me nr protokoli 01-400/01-51414 të datës 26.11.2023 parcela kadastrale Nr 70315016-01016-1 e ka prezantuar certifikaten e biznesit dhe listen e punëtorëve dhe pagesat ndaj Komunës së Glllogocit dhe komisioni ka konstatuar se e drejta e shfrytëzimit të tokës është e regjistruar në RDPP, e kemi marrur edhe deklarin nga Drejtoria për Buxhet e Financa të Komunës së Glllogocit se i ka kryer obligimet deri në muajin nëntor 2023 obligim ka mbet për muajin dhjetor 2023 dhe biznesi është duke punuar.

Në bazë të vizitës në terren me datë 20.12.2023 në sublektet afariste IP KOS SHPK në Drenas (Glllogoc) kemi hasur se në objektin ku zhvillon afarizmin subjekti në fjalë, zhvillojnë edhe veprimtari afariste tjera të cilat ushtrojnë aktivitete ekonomike si: restorante – heb's, Market, Misini, Aztech dhe Waikiki.

Në momentin e vizitës në terren të Operatorit Ekonomik IP-KOS SHPK në Arllat gjendja është konstatuar se Operatori Ekonomik IP-KOS SHPK me pronar Burim Leci dhe me kontratë të nënshkruara nga kryetari z.Ramiz Lladrovci dhe Burim Leci, Drejtor me nr protokolli 01-400-51418 të datës 26.11.2023 parcela kadastrale Nr 70310058-02652-2 e ka prezantuar certifikaten e biznesit dhe listen e punëtorëve dhe pagesat ndaj Komunës së Glllogocit dhe komisioni ka konstatu së e drejta e shfrytëzimit të tokës është e regjistruar në RDPP, e kemi marr edhe deklarin nga Drejtoria për Buxhet e Financa të Komunës së Glllogocit se i ka kryer obligimet për Komunën e Drenasit (Glllogocit) për vitin kalendarik 2023 biznesi është duke punuar.

Në bazë të vizitës në terren me datë 20.12.2023 në subjektin afaristë IP KOS SHPK në Arllat kemi hasur se zhvillohen veprimtari: Market, restaurant dhe brenda në restaurant e ku shifet edhe reklama e Heb's-it.

Në momentin e vizitës në terren të Operatorit Ekonomik Fer-Petrol në Glllobar gjendja është konstatuar se Operatori Ekonomik me pronar Mehdi Gjoka dhe me kontratë të nënshkruara nga kryetari z.Ramiz Lladrovci dhe Mehdi Gjoka, Drejtor me nr protokolli 01-400/01-51408 të datës 26.11.2023 parcela kadastrale Nr 70314035-01979-0 e ka prezantuar certifikaten e biznesit dhe listen e punëtorëve dhe pagesat ndaj Komunës së Glllogocit dhe komisioni ka konstatu së e drejta e shfrytëzimit të tokës është e regjistruar në RDPP, e kemi marr edhe deklarin nga Drejtoria për Buxhet e Financa se i ka kryer obligimet nga Komuna e Glllogocit dhe biznesi është duke punuar,

Në bazë të vizitës në terren me datë 20.12.2023 në sublektet afariste Fer Petrol përveq riaktivizimit dhe rivitalizimit te kapaciteteve ekzistuese shifet si është investu edhe në depo .

Në momentin e vizitës në terren të Operatorit Ekonomik Ragip Veseli në Komoran gjendja është konstatuar se Operatori Ekonomik me pronar Ragip Veseli dhe me kontratë të nënshkruara nga kryetari z.Ramiz Lladrovci dhe Ragip Veseli, me nr protokolli 01-400-51386 të datës 26.11.2023 parcela kadastrale Nr 70315015-00764-0 e ka prezantuar certifikaten e biznesit dhe listen e punëtorëve dhe pagesat ndaj Komunës së Glllogocit dhe komisioni ka konstatu së e drejta e shfrytëzimit të tokës është e regjistruar në RDPP, e kemi marr edhe deklarin nga Drejtoria për Buxhet e Financa të Komunës së Glllogocit se i ka kryer obligimet e pagesave dhe biznesi është duke punuar.

Në bazë të vizitës në terren me datë 20.12.2023 në subjektin afarist MOL Group L.L.C në parcelën kadastrale Nr 70315015-00764-0 këtu certifikata e biznesit i ka dy pronar personin që e posedon tokën në shfrytëzim edhe një tjetër edhe këtu zhvillon edhe veprimtari afariste tjera të cilat i ushtrojn aktivitetet si Market, Resaturant dhe brenda restaurantit e ka reklamen e Heb's edhe në ketë parcel dhe në objekt figuron edhe një reklam me emërtim IP.

Në momentin e vizitës në terren të Operatorit Ekonomik Elkos Shpk me Drejtor Servete Abazi, Drejtor në Komoran me kontratë të nënshkruara nga kryetari z.Ramiz Lladrovci dhe Servete Abazi, me nr protokolli 01-400/01-51545 të datës 26.11.2023 parcela kadastrale Nr 70314035-00202-1 e ka prezantuar certifikaten e biznesit dhe listen e punëtorëve dhe pagesat ndaj Komunës së Gllogocit dhe komisioni ka konstatuar se e drejta e shfrytëzimit të tokës është e regjistruar edhe ne RDPP,e kemi marr edhe deklarin nga Drejtoria për Buxhet e Financa të Komunës së Gllogocit se i ka kryer obligimet e pagesave dhe biznesi është duke punuar. Në këtë biznes zhvillon veprimtarin Market, Restaurant.

Komisioni:

Bujar Plakiqi

Fadil Tahiri

Flora Krasniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit- Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	22 / 01 / 2024		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01 - 030/n1 - 3768			

PLANI I PUNËS SË KKSBB-SË PËR VITIN 2024

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas këtij udhëzimi puna e KKSB-së duhet bazohet gjithmonë në dispozitat që rregullojnë çështjen e funksionimit si një organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Plani i mëposhtëm përfshin disa nga objektivat dhe aktivitetet që do të realizohet gjatë vitit 2024 me qëllim të realizimit të detyrave të parapara sipas Udhëzimit Administrativ.

Përmes këtij plani synohet:

Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në bashkësi;

Identifikimi i shqetësimeve lidhur me sigurinë publike dhe adresimi i tyre të autoritetet përkatëse;

Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve/komuniteteve për çështjet që prekin sigurinë publike

Duke u bazuar në nenin 9 'Detyrat dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të KKSB-së, pika 1.7, KKSB duhet të hartoj Planin Vjetor të Punës, dhe të njëjtin ta prezantoj edhe në Kuvendin Komunal për miratim.

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB) -DRENAS


Aktiviteti	Objektivat	Periudha kohore	Rezultati	Përgjegjës
Takimet e rregullta mujore të KKSBB-së	Prezantimi i punës mujore të KKSBB-së	Janar-Dhjetor	KKSBB funksionale	KKSBB
Raportimi në Kuvendin komunal për aktivitetet e KKSBB-së	Informimi i Kuvendit mbi aktivitetet e KKSBB-së	Qershor-Gjashtëmujori i parë dhe Dhjetor-Gjashtëmujori i dytë	Zbatimi i udhëzimit për Këshilla Lokal të Sigurisë dhe Informim i Kuvendit për punën e KKSBB-së	Kryesuesi i KKSBB-së
Publikimi i lajmeve përmes ueb faqes së Komunës së Drenasit dhe formave të tjera mediatike	Promovimi i punës së KKSBB-së në opinion	Sipas nevojës	Informimi dhe promovimi i punës së KKSBB-së	Koordinatorja/Anëtarët e KKSBB-së
Përgatitja e projekteve në bazë të problemeve të identifikuara nga anëtarët e KKSBB	Prezantimi i ideve për mundësitë e zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen me sigurinë në shkolla, ambiente, sigurinë shëndetësore, sigurinë rrugore, institucionale për temat si në vijim 1. Siguria Fizike a) Përdorimi i armëve (dasmat); b) Shkolla (dukuritë negative, çështje tjera të sigurisë etj.); c) Qentë endacakë; d) Lypësit e rrugës; e) Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, (bashkëpunim me FSK-së dhe DKA-së); f) Ndriçimi publik; g) Statistikat e përgjithshme të krimeve; h) Rrjetet elektrike dhe trafot; i) Identifikimi i rreziqeve të mundshme. 2. Siguria e Ambientit a) Deponitë e mbeturinave; b) Ekspozimi i mallrave në ambiente të hapura; c) Zjarret fushore dhe malore - parandalimi i tyre; d) Dezinfektimi, dezinfektimi, deratizimi etj.	Janar – Dhjetor	Përgatitja e projekteve në bazë të problemeve të identifikuara nga anëtarët e KKSBB	Anëtarët e KKSBB-së

	3. Siguria Shëndetësore a) Përdorimi nga të rinjtë i narkotikeve dhe cigareve dhe shitja e tyre pranë shkollave –parandalimi; b) Ri-integrimi i personave të riatdhesuar; c) Furnizimi me ujë të pijes. 4. Siguria Rrugore a) Mbulimi i pusetave; b) Shenjat në rrugë; c) Vijat e bardha (zebrat); d) Renovimi i pjesëve të rrugëve ku ka dëmtime-parandalimi i dëmtimeve; e) Zgjerimi i rrugëve sipas standardeve (Zgjedhja e kontesteve pronësore); f) Largimi i “policëve” të shtrirë ilegal. 5. Siguria Institucionale a) Vendosja e kamerave; b) Shkallët emergjente nëpër ndërtesa; c) Qendra për Alarmim etj. 6. Propozime tjera Përveç temave të mësipërme Kryetari i Komunës dhe anëtarët e KKSB-së mund të propozojnë tema tjera me interes për sigurinë publike në Komunën e Drenasit.			
Hartimi i raportit vjetor për punën e KKSB-së gjatë vitit 2024	Analizë e punës së KKSB-së për punën gjatë vitit	Janar 2024	Rishikim i aktiviteteve, mundësi për ndryshime në plan duke u bazuar në aktivitetet e pasqyruara në raport.	Koordinatorja e KKSB-së
Vlerësimi i punës së KKSB-së.	Vlerësimi i punës nga anëtarët e KKSB-së dhe diskutime për të ardhmen e këtij Këshilli.	Para datës 15 dhjetor të vitit 2024	Përgatitja e aktiviteteve për vitin e ardhshëm	Anëtarët e KKSB-së

Me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e sigurisë në bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr. 04/1-076, për policinë, nenit 11, pika 2 e Udhëzimit administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për KKSBB-së është propozuar dhe votuar në mbledhjen e KKSBB-së që në vitin 2024 të punohet sipas këtij orari.

<i>Nr. rend</i>	<i>Data e mbajtjes së takimit</i>	<i>Ora dhe Vendi</i>	<i>Lloji i mbledhjes</i>
<i>1</i>	<i>18 Janar 2024</i>	<i>14:00, Salla e Kuvendit</i>	<i>Mbledhje e rregullt</i>
<i>2</i>	<i>18 Prill 2024</i>	<i>14:00, Salla e Kuvendit</i>	<i>Mbledhje e rregullt</i>
<i>3</i>	<i>13 Qershor 2024</i>	<i>14:00, Salla e Kuvendit</i>	<i>Mbledhje e rregullt</i>
<i>4</i>	<i>15 Gusht 2024</i>	<i>14:00, Salla e Kuvendit</i>	<i>Mbledhje e rregullt</i>
<i>5</i>	<i>24 Tetor 2024</i>	<i>14:00, Salla e Kuvendit</i>	<i>Mbledhje e rregullt</i>
<i>6</i>	<i>13 Dhjetor 2024</i>	<i>14:00, Salla e Kuvendit</i>	<i>Mbledhje e rregullt</i>

Shënim: Ky orar mund të ndryshojë në varësi të agjendës dhe angazhimeve të kryesuesit të KKSBB-së.

 **Kryetari i Komunës**

Ramiz Lladrovci